



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 12. 11.2013, në orën 13.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e Komisionit: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Duda Balje.

Mungoi: Justina Shiroka – Pula.

Stafi mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi – Zyrtar i lartë ligjor, Sulltane Gashi - zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri – mbështetës i Komisionit.

Pjesëmarrësit e tjerë: Jelena Doredviq- RTK 2, Shkumbin Asllani-CRDP, Fehmi Pireva-Kuvendi i Kosoves, Bukurie Bajraliu-Koha Ditore, Arben Sylejmani-Jeta në Kosovë, Arben Brajshori-Rrokum TV, Adem Breznica-Kosova Live, Visar Bivolaku-EUO/EUSR, Ukë Gashi-ZRPK, Lejla Selimi-OSBE dhe Nuredin Ibishi UNDP.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 8 dhe 22 tetor 2013;
3. Miratimi i Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012;

4. Shqyrtimi i Raportit të KMDL NJ-së, për monitorimin e Qendrave të Ndalimit, Qendrave të Paraburgimit dhe Qendrave Korrektuese;
5. Shqyrtimi i peticioneve;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 8 dhe 22 tetor 2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 8 tetor u miratua pa vërejtje, ndërsa procesverbali i dt. 22 tetor u miratua me vërejtjet e anëtares së Komisionit Biserka Kostic e cila tha se Avokati i Popullit e ka përdorur fjalën raciste ndaj saj.

3 Miratimi i Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012

Kryetarja – Duke u ndërlidhur me Raportin vjetor të IAP-së tha se e kanë shqyrtuar këtë raport në takimin e kaluar dhe pasi që kanë pasur vërejtje lidhur me përmbajtjen e tij kanë vendosur që miratimin ta bëjnë në këtë takim. Ajo theksoi se vërejtjet të cilat i kanë paraqitur anëtarët e Komisionit është dashur të merren parasysh nga ana e Avokatit të Popullit, mirëpo disa nga vërejtjet që kanë paraqitur ata nuk janë marrë parasysh nga ana e Avokatit dhe nuk janë përfshirë në raport. Ajo tha se ka bërë krahasimin e raportit pas përmirësimit me qëllim të vërtetimit se a janë marrë parasysh vërejtjet që ajo ka paraqitur. Ajo i informoi anëtarët se ka pasur vërejtje që në raport nuk është përfshirë çështja e diskriminimit dhe kjo vërejtje nuk është marrë parasysh edhe pas përmirësimit të raportit dhe ishte e mendimit se ky raport është i zbrazët sa i përket diskriminimit. Sa i përket rasteve të dhunës lidhur me të cilat ajo ka pasur vërejtje se janë paraqitur statistikave vetëm për dy komuna, ajo tha se janë bërë disa përmirësime, por të pamjaftueshme sepse janë paraqitur statistika për 6 komuna, kurse për komunat e tjera mungojnë. Lidhur me arsimimin e minoritetit serb në Kosovë, i cili punon në bazë të plan-programit të Serbisë dhe që paguhet nga dy palët, ajo ka pasur vërejtje se Avokati i Popullit duhet të rekomandojë për këtë rast. Mirëpo ajo tha se edhe pas përmirësimeve të raportit nuk ka ndryshime në këtë rast. Sa i përket disa çështjeve për të cilat IAP nuk ka dhënë rekomandime, mirëpo vetëm i ka paraqitur në raport. Edhe përkundër vërejtjeve të saj lidhur me këto çështje një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe nuk janë marrë parasysh vërejtjet për paraqitjen e rekomandimeve në raport.

Ajo ishte e mendimit se vërejtjet është dashur të merren parasysh, sepse ato janë bërë me qëllim që raporti të jetë sa më i kompletuar. Mirëpo ka vërejtur se shumë nga vërejtjet nuk janë marrë parasysh nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Albana Gashi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se në takimin e kaluar ka dhënë disa vërejtje gjatë shqyrtimit të raportit dhe pas arritjes së raportit të përmirësuar ajo konstatoi se janë përmirësuar vetëm ato vërejtjet teknike që ka pasur, por jo edhe vërejtjet

përmbajtjesore. Si vërejtje që ajo përmendi ishte tek e drejta për jetën, ku ajo ka pasur vërejtje të mos përfshirja e rastit të sulmit ndaj familjes së Selver Haradinajt, me ç' rast ai ka humbur jetën dhe anëtarët e familjes së tij janë plagosur. Sipas saj kjo është dashur të përfshihet në raport, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur edhe pas paraqitjes së vërejtjeve nga ana e saj. Ajo theksoi se ka bërë vërejtje për lirinë e lëvizjes, si dhe pengimin e ndërtimit të shtëpive të shqiptarëve, por as kjo nuk është marrë parasysh nga Avokati gjatë përmirësimit të raportit.

Ajo tha se lidhur me mospërfshirjen e këtyre rasteve Avokati është arsyetuar se nuk ka pasur ankesa lidhur me këto qështje dhe për këtë arsye nuk janë përfshirë në raport kurse për rastet e demolimit të varrezave serbe Institucioni i Avokatit të Popullit është bazuar në mediumet serbe dhe nuk ka pasur ankesa të tjera dhe në këtë mënyrë këto raste i ka paraqitur në raport.

Në fund ajo tha se do të abstenojë në këtë raport pasi që nuk janë marrë parasysh vërejtjet që ajo ka paraqitur dhe nuk janë përfshirë edhe pas përmirësimit të raportit.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Duke u ndërlidhur me përmbajtjen e raportit tha se takimi në të cilin është shqyrtuar raporti ka qenë i gjatë dhe janë paraqitur shumë vërejtje nga ana e anëtarëve të Komisionit. Duke pasur parasysh Ligjin për Avokatin e Popullit ajo tha se Kuvendi është institucion i cili e mbikëqyrë punën e Avokatit të Popullit dhe mund t'i japë rekomandime të ndryshme. Lidhur me rastin konkret ajo kishte vërejtje që pavarësisht rekomandimeve që kanë dhënë anëtarët e Komisionit, me qëllim të përmirësimit të disa pikave në raport, ato nuk janë marrë parasysh gjatë ndryshimit të raportit i cili edhe ashtu ka arritur me vonesë në Kuvendin e Kosovës. Në fund ajo tha se është shumë e vështirë që të kalojë ky raport në Seancën Plenare kur nuk e ka përkrahjen e Komisionit funksional, sepse është raport i mangët. Ajo e theksoi se për këtë qëllim mbahet mbledhja e Komisionit në të cilin ftohet edhe Avokati i Popullit me qëllim të përmirësimit të vërejtjeve që paraqiten nga anëtarët e Komisionit. Edhe ajo vendosi që të abstenojë gjatë miratimit të këtij raporti.

Kurtan Kajtazi – Theksoi se përkundër vërejtjeve që janë paraqitur nga anëtarët e Komisionit raporti nuk është përmirësuar. Ai tha se Komisioni vazhdimisht ka qenë i gatshëm të bashkëpunojë me Institucionin e Avokatit të Popullit duke u munduar të gjejnë zgjidhje në vështirësitë që ka pasur në punë dhe çështjet e tjera që kanë qenë të nevojshme për punën e këtij institucioni dhe nuk është në rregull që mos të përfillen rekomandimet e Komisionit lidhur me raportin. Ai ishte i mendimit që t'i rekomandohet Institucionit të Avokatit të Popullit që brenda një javë të plotësojë vërejtjet e paraqitura nga ana e anëtarëve të Komisionit. Ai ngriti shqetësimin e tij lidhur me vonesën e raportit duke theksuar se Raporti vjetor në vazhdimësi po vonohet dhe kjo është çështje për të cilën Avokati i Popullit duhet të jetë më i përpiktë në respektimin e datave të përcaktuara me ligj.

Kryetarja – Tha se anëtarët e Komisionit nuk kanë kërkuar nga Avokati i Popullit që të ndryshojë fakte, por kanë kërkuar plotësimin e disa çështjeve të cilat nuk i ka përfshirë në raport. Ai ishte i mendimit të njëjtë me anëtarët e Komisionit që t'i jepet një kohë për përfshirjen e vërejtjeve në raport, në mënyrë që raporti të jetë sa më i kompletuar.

Biserka Kostiq – Kishte vërejtje që as në raportet e kaluara dhe as në këtë raport nuk është e përfshirë çështja e personave të zhdukur. Ajo tha se Avokati i Popullit merret me çështjet që dëshiron dhe jo me ato që janë me rëndësi. Ajo e theksoi se çështja e personave të zhdukur nuk përmendet as në raportit e vitit të kaluar dhe as në këtë raport që është paraqitur tani. Ajo ishte e mendimit që të përfshihen në raport gjendja aktuale e çështjes së personave të zhdukur në mënyrë që të mund të konstatohet se si është gjendja me personat e zhdukur.

Kryetarja – Pyeti anëtarët e Komisionit se a janë të pajtimit që t'i rekomandohet Avokatit të Popullit në mënyrë që të merren parasysh vërejtjet e anëtarëve dhe nëse nuk i merr parasysh vërejtjet, t'i paraqitet Komisionit një arsyetim se pse nuk merren parasysh vërejtjet e caktuara.

Albana Gashi – Tha se Avokati i Popullit ka qenë prezent takimin e kaluar dhe tani Komisioni mund t'i rekomandojë që t'i marrë parasysh vërejtjet e paraqitura nga ana e anëtarëve të Komisionit. Ajo tha se nëse ata nuk i kanë shënimet do t'i dërgohet materiali nga ana e stafit të Komisionit.

Kryetarja e obligoi stafin e Komisionit që t'ia dërgojë procesverbalin e mbledhjes Institucionit të Avokatit të Popullit në mënyrë që t'i kenë të gjitha vërejtjet e paraqitura nga ana e anëtarëve të Komisionit dhe të merren parasysh.

Pas një debati të gjerë lidhur me këtë çështje, Komisioni me votim unanim vendosi që t'i lihet një kohë Institucionit të Avokatit të Popullit që t'i përfshijë vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e Komisionit në raport.

4. Shqyrtimi i Raportit të KMDLNJ-së, për monitorimin e Qendrave të Ndalimit, Qendrave të Paraburgimit dhe Qendrave Korrektuese

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se në këtë raport janë të paraqitura në detaje monitorimet e qendrave korrektuese dhe ishte e mendimit se i njëjti raport duhet të procedohet për njoftim në Kuvend.

Kurtan Kajtazi – Ishte i mendimit që më mirë të ftohet përfaqësuesi i KMDLNJ –së në mënyrë që të referohen në Komision, e më pas të procedohet për Seancë Plenare.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Duke u ndërlidhur theksoi se nuk është e nevojshme që të ftohen në Komision, pasi ky është raport dhe është e nevojshme që të njoftohen deputetët në Seancën Plenare.

Albana Gashi – Tha se çështjen e qendrave korrektuese e kanë paraqitur disa herë në Kuvend dhe Komisioni vazhdimisht ka qenë në vizita duke e konstatuar gjendjen që është atje dhe kjo gjendje është e paraqitur në raport. Ajo ishte e mendimit që të njoftohet Kuvendi me këtë raport, por e theksoi se më mirë do të ishte që të ftohet ministri Hajredin Kuçi në Komision në mënyrë që të debatohet për gjendjen e burgjeve, sepse në Kuvend nuk pa ka efekt me mekanizmat e tillë.

Kryetarja – Lidhur me përmbajtjen e raportit tha se është real dhe ishte e mendimit të njëjtë me disa anëtarë të Komisionit që të njoftohet Kuvendi me këtë raport.

Kurtan Kajtazi – Ishte i mendimit që të verifikohen të metat që janë potencuar në raport dhe të vizitohen qendrat korrektuese në mënyrë që të vërtetohet gjendja e paraqitur në raport.

Albana Gashi – Theksoi se 3 apo 4 herë në vit e kanë vizituar qendrën e Dubravës dhe nuk ishte e mendimit që të njoftohet vetëm Kryesia e Kuvendit, por të ftohet në Komision ministri i Drejtësisë, sepse me njoftimin e Kryesisë dhe Kuvendit çështja mbaron aty dhe nuk vazhdon tutje asnjë veprim tjetër.

Kryetarja – Duke u ndërlidhur me çështjen e raportit tha se atyre nuk iu ndalohej që t'i vizitojnë qendrat korrektuese në bazë të dhënave të raportit edhe pasi që të njoftohet Kuvendi me këtë dhe pasi që të realizohen vizitat ajo nuk e përjashtojë mundësinë e thirrjes në takim të ministrit të Drejtësisë, në mënyrë që të debatohet për këtë çështje, por lidhur me këtë raport ajo tha se duhet të njoftohet Kryesia dhe Kuvendi.

Kymete Bajraktari – Ishte e mendimit që patjetër duhet të njoftohen me përmbajtjen e raportit Kryesia, Kuvendi dhe Qeveria dhe t'i jepet një kohë e caktuar Qeverisë në mënyrë që t'i realizojë këto rekomandime dhe pastaj të monitorohet gjendja se sa i ka realizuar Qeveria rekomandimet e dala nga ky raport. Ajo ishte e mendimit të njëjtë me anëtarët e tjerë në lidhje me monitorimin e qendrave korrektuese dhe në fund thirrjen në takim të ministrit të Drejtësisë.

Kimete Bytyqi – Shfaqti mendim të njëjtë me anëtarët e tjerë të Komisionit që të njoftohet Qeveria me përmbajtjen e këtij raporti.

Pas një debati lidhur me këtë çështje me votim unanim u vendos që me përmbajtjen e këtij raporti të njoftohet Kryesia e Kuvendit, Deputetët dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi i peticioneve

Kryetarja para se t'u japë fjalën anëtarëve të grupit punues për shqyrtimin e peticioneve i njoftoi anëtarët e Komisionit me Njoftimin për papranueshmëri nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me kthimin në punë të ish- drejtorit të Administratës në Institucionin e Avokatit të Popullit, z. Arsim Agani. Ajo tha se në rekomandim që Komisioni i ka bërë Institucionit për ta zbatuar Vendimit e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për kthimin në punë të z. Arsim Agani nuk kanë marrë ende përgjigje nga ky institucion.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Duke u ndërlidhur me çështjet e z. Arsim Agani theksoi se ky rast ka bërë bujë të madhe edhe në media si dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka marrë vendim me të cilin duhet të kthehet në punë z. Agani. Ajo tha se asnjë institucion tjetër

nuk mund ta refuzojë kërkesën për kthim në punë dhe sipas mendimit të saj Avokati i Popullit ka bërë një gabim shumë të madh me moszbatimin e vendimit për kthimin në punë të z. Arsim Aganit.

Në vazhdim ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit me një shkresë të Bogolub Staletoviq i cili është zëvendësavokat i Popullit dhe ka paraqitur disa shkelje, apo mohime të të drejtave ndaj tij nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Ajo paraqiti konstatimin e Grupit Punues për shqyrtimin e peticioneve sipas të cilit kërkojnë nga Bogolub Staletoviq që të përmbledh të gjitha kërkesat e tij në një shkresë në mënyrë që të qartësohet situata e krijuar.

Biserka Kostiq – Tha se nuk kanë asgjë kundër Avokatit të Popullit, mirëpo këto janë konstatime nga lënda që është dorëzuar në Komision në të cilën paraqiten shkelje apo mohim të të drejtave. Ajo theksoi se në këtë lëndë ka mjaft argumente në të cilat vërtetohet se këtu ka mohim të të drejtave të njeriut nga Institucioni i Avokatit të Popullit i cili duhet të jetë shembull i respektimit të drejtave të njeriut. Ajo propozoi që në takim të ftohet z. Bogolub Staletoviq dhe në mënyrë direkte ta njoftojë Komisionin me çështjen problematike që është krijuar në mënyrë që të vërtetohen shkelja e të drejtave të cilat ligji ia garanton dhe që ai nuk po mundet t'i realizojë.

Kurtan Kajtazi – Tha se kjo lëndë ka paqartësi sepse nuk është peticion dhe më shumë i përngjan një raporti i cili paraqet shkelje apo mohim të të drejtave dhe nuk sqarohet se a është në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit, apo në emër të tij personal. Ai propozoi që të ftohet z. Staletoviq në takim në mënyrë që të sqarohen disa çështje. Ai në vazhdim tha se në pjesën e parë të kësaj lënde, të cilën e ka dërguar zëvendësavokati i Popullit, z. Bogolub Staletoviq, si shkeljen që ka paraqitur është mosrespektimi i vendimit të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i datës 6 tetor, në të cilin është vendosur që të kthehet në punë, z. Arsim Agani dhe ky vendim nuk është zbatuar nga Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi. Ai tha se kjo është shumë shqetësuese kur institucionet e pavarura, siç është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, nuk respektohen nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Ai theksoi se nuk është kompetencë e Avokatit të Popullit të konstatojë se a ka të drejtë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës në marrjen e vendimit apo jo. Ai përmendi raste të tjera të ngjashme të cilat Avokati i Popullit ka bërë presion që të zbatohen vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës që të kthehen personat në marrëdhënien e punës, e në këtë rast ai nuk e zbaton vendimin që është i njëjtë me vendimet e tjera për të cilat ai ka konstatuar se duhet të zbatohen. Në fund ai tha se përveç thirrjes së zëvendësavokatit të Popullit duhet të thirret edhe Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi në mënyrë që të japë sqarime lidhur me rastet e paraqitura.

Kryetarja – U pajtua me propozimin që në takim të ftohet zëvendësavokati i Popullit, z. Bogolub Staletovic, por e kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit se a është më mirë të ftohen bashkërisht zëvendësavokati i Popullit dhe Avokati i Popullit.

Biserka Kostiq – Ishte e mendimit se më mirë është që të paraqiten ndaras në takim në mënyrë që të paraqiten vërejtjet në mënyrë më të qartë.

Kymete Bajraktari – Tha se është më mirë që të dy të jenë prezent dhe të ballafaqohen sepse nëse zëvendësavokati ka pasur guximin të gjitha shkeljet t'i përmbledh në atë mënyrë duhet ta ketë guximin dhe të përballet direkt me Avokatin e Popullit.

Kryetarja – Ishte e mendimit të njëjtë që të ftohen të dy së bashku në mënyrë që të paraqesin mendimet e tyre.

Albana Gashi – Tha se është mirë që të dëgjohen mendimet si të qytetarit i cili nuk është kthyer në punë, po ashtu edhe të Avokatit të Popullit. Ajo ishte e mendimit të njëjtë që nëse zëvendësavokati ka pasur guximin t'i paraqesë vërejtjet në letër duhet ta ketë guximin të përballet direkt.

Pas një debati lidhur me këtë çështje u vendos që në takimin e radhës të ftohen Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi dhe zëvendësavokati i Popullit, z. Bogolub Staletoviq.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Lidhur me kërkesën e dytë tha se fillimisht është udhëzuar pala që ta kompletojë dokumentacionin në mënyrë që të plotësohen kushtet formale, e pastaj duhet të vizitojnë këtë qendër në mënyrë që të vërtetohet gjendja e krijuar në terren. Ajo i informoi se lënda ka të bëjë me disa institucione parashkollë të minoriteteve në Prizren, mirëpo kjo do të shqyrtohet vetëm pas kompletimit të lëndës dhe plotësimit të kushteve formale.

6. Të ndryshme

Kurtan Kajtazi – Lidhur me Rregulloren për Shqyrtimin e Peticioneve tha se është mirë që kjo të miratohet nga Komisioni, sepse është punuar shumë në këtë drejtim dhe pasi që ky dokument ka kaluar në leximin e parë në Komision është mirë që të shqyrtohet dhe të miratohet nga Komisioni. Ai propozoi që në takimin e radhës të shqyrtohet ky dokument dhe mos të kalojë ky vit pa e miratuar këtë dokument i cili ka rëndësi për shqyrtimin e peticioneve.

Kryetarja – Ishte e mendimit të njëjtë se është me rëndësi që qytetarët ta kenë një udhëzues dhe ta dinë se në cilat raste mund t'i drejtohet Kuvendit kur ka çështje të shkeljeve të drejtave. Ajo tha se takimin e radhës do ta kenë udhëzuesin, mirëpo anëtarët do ta kenë paraprakisht në mënyrë që të mund t'i japin vërejtjet e tyre lidhur me këtë dhe në takimin e radhës të inkorporohen ato vërejtje dhe në këtë mënyrë të miratohet udhëzuesi.

Albana Gashi – Ngriti çështjen e kërkesës së mëhershme e cila ka të bëjë me çështjen e ndërmarrjeve që janë privatizuar me Spin Of Special, e që nuk e kanë vazhduar veprimtarinë e tyre siç është rasti i ndërmarrjes “ Suhareka “. Ajo tha se fillimisht ka qenë ideja që, si Komision, të kërkojnë të ngrihet një debat parlamentar, mirëpo në të kundërtën nëse kjo nuk bëhet ata do të jenë të shtyrë që ta marrin këtë iniciativë si deputet si grupe parlamentare. Ajo theksoi se krejt kjo vjen si shkak i ankesave të shumta të qytetarëve se ka ndodhur shkelje të drejtave të punëtorëve.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Tha se si Komision ata mund ta ftojnë Institucionin e AKP-së si dhe përfaqësuesit e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, sepse Dhoma e Posaçme është duke bërë padrejtësi qytetarëve pasi kjo është formuar enkas për qeshjet e privatizimit. Ajo ishte e mendimit se këto veprime mund t'i marrin si Komision, kurse thirrjen e Seancës Plenare nuk mund ta bëjnë si Komision, sepse ajo është çështje e grupeve parlamentare dhe jo e Komisionit.

Kimete Bytyqi – U pajtua me idenë që fillimisht të ftohen në takim përfaqësuesit e pastaj si deputet, apo si grup parlamentar ta ngritin këtë çështje në Kuvend.

Kryetarja – Theksoi se me propozim të Komisionit në të kaluarën janë bërë tri debate parlamentare dhe lidhur me këtë rast ajo kishte paqartësi se pse nuk mund të bëhet një propozim i tillë. Ajo kërkoi bazën juridike sipas të cilës nuk i lejohet Komisionit të bëjë një propozim të tillë për çështjen e privatizimit.

Kurtan Kajtazi – Duke u ndërlidhur theksoi se pajtohet me mendimin e koleges Rita Hajzeraj – Beqaj se ka pasur shumë ankesa të qytetarëve. Mirë nuk kanë mundur t'i shqyrtojnë ankesat e qytetarëve të cilat në të njëjtën kohë kanë qenë edhe në shqyrtim gjyqësor, sepse nuk e kanë një kompetencë të tillë. Ai ishte i mendimit që nëse vendoset të ftohen përfaqësuesit e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme fillimisht duhet që t'i përmbledhin të gjitha ankesat që janë paraqitur në Komision në mënyrë që ta qartësojnë situatën dhe të mos merren me ato ankesa të cilat janë në shqyrtim gjyqësor.

Albana Gashi – Tha se është fjala për ndërmarrjet për të cilat nuk është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore.

Kryetarja – Tha se është me vend ideja që të ftohen në takim përfaqësuesit e Institucionit të Privatizimit dhe pastaj të analizojnë mundësinë e ndërmarrjes së hapave të tjerë.

Albana Gashi – Duke u ndërlidhur theksoi se ata në të kaluarën kanë ftuar përfaqësuesit në takim dhe ata vetëm sa i shmangen realitetit duke i ikur përgjegjësisë për gjendjen e krijuar.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Ishte e mendimit që shkaktar i të gjithë kësaj është mungesa e Bordit i cili nuk është i kompletuar dhe nuk mund të marrë vendime dhe për këtë arsye janë grumbulluar një numër i madh i lëndëve.

Albana Gashi – Ngriti një shqetësim tjetër lidhur me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ku ankesa duhet të paraqitet edhe në gjuhën angleze që përmban shkelje të drejtave, sepse gjuhë zyrtare në Kosovë nuk është gjuha angleze.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Ishte e mendimit që fillimisht të ftohen përfaqësuesit e AKP-së në mënyrë që të qartësohet situata se kush është përgjegjës për situatën e krijuar, e pastaj për këtë çështje ajo tha se duhet të njoftohet edhe Kuvendi.

Pas një debati lidhur me këtë çështje u vendos që në takimin e radhës të ftohen përfaqësuesit e AKP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali